



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202003409/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda: Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Shkodër.

Drejtuar: Drejtues i parë Niko Brahimaj
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër

SHKODËR

Kryekomisar Paulin Çupi
Shef i Komisariatit të Policisë Shkodër

SHKODËR

Për dijeni: Drejtues Madhor Ardi VELIU
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit

TIRANË

Të nderuar,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 i ligjit nr.81/2020 datë 25.06.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, zhvilloi një inspektim në Komisariatin e Policisë Shkodër.

Inspektimi u krye në datën 22.12.2020, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Hazbi Selita, z. Besnik Deda, znj. Nertila Qafzezi, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", në Procedurën Standarde "Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, në Procedurën Standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i vitit të kaluar.

Avokati i Popullit, bazuar në konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetasit e privuar nga liria, grupi i inspektimit, u takua me shefin e Komisarariatit z. Paulin Çupi dhe shefin e rendit dhe policimit në komunitet z. Sajmir Rustemi, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, shefi i komisarariatit informoi grupin e inspektimit mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit referuar inspektimit të mëparshëm, lidhur me përmirësimin e kushteve në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në këtë komisarariat, sipas procedurave standarde dhe për rritjen e performancës së punonjësve të policisë për respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar, arrestuar/ndaluar.

Grupi inspektimit është informuar se projekti i miratuar është vënë në zbatim dhe tashmë është ndërtuar një godinë e re me 4 kate. Punimet në pjesën më të madhe të godinës kanë përfunduar dhe ka filluar veprimtaria e punës normalisht në administratë, në zyrat e pritjes së qytetareve dhe në dhomat e shoqërimit. Struktura ishte ndërtuar **sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”**, dhe aktit të procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së shtetit”, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Dhomat e shoqërimit ishin të ndara më vete për rritur, femrat dhe të miturit, **duke krijuar mjedise të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera**. Ndërkohë, u konstatua se nuk kishin përfunduar punimet për dhomat e sigurisë, të cilat ishin në ndërtim e sipër. Ishin të parashikuara 14 dhoma sigurise, brenda standardeve bashkëkohore dhe përcaktimeve të bëra në aktet ndërkombëtare dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Kapaciteti i ambienteve ishte për 14 persona të ndaluar/të arrestuar, të ndarë sipas dhomave

Grupi i inspektimit pasi mori informacionin e nevojshëm, vijoi me inspektimin e ambientit të shoqërimit dhe atij të sigurisë (në ndërtim), për verifikimin e parametrave në të cilën janë ndërtuar dhomat e shoqërimit dhe po ndërtohen dhomat e sigurisë, plotësimi i kriterëve për ndërtimin e dhomave dhe rregullat që zbatohen nga personeli i shërbimit policor për respektimin dhe garantimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu, **grupi i inspektimit vizitoi edhe zyrat e specialistëve dhe të ndihmës specialistëve të policisë, që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar, dhe kontrolloi e administroi dokumentacionin përkatës, ku pasqyrohen veprimet e kryera me këta persona**. Gjatë ushtrimit të detyrës për inspektimin e ambienteve ku mbahen dhe trajtohen personat e privuar nga liria, grupi inspektues ishte i shoqëruar nga shefi i rendit të Komisarariatit të Policisë Shkodër dhe punonjësit e policisë që kryejnë shërbimin në këto ambiente.

Nga informacioni dhe verifikimi i rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit të dërguara në përfundim të inspektimit të kryer në vitin 2019, rezulton se ishte plotësuar

rekomandimi për krijimin e zyrave të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, në dhomat e shoqërimit dhe në korridoret e ambienteve të shoqërimit dhe ishte parashikuar dhe në ato të sigurisë.

Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se në Komisarlatin e Policisë Shkodër ishin marrë disa masa serioze dhe të rëndësishme për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar.

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Shkodër, ambientet e shoqërimit ishin të ndërtuar sipas kritereve të parashikuara në procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ato ndodheshin në katin e parë godinës, dhe përbëheshin nga tre dhoma shoqërimi një (1) për persona të rritur, një (1) për femra dhe një (1) për të mituri.

Dhomat e shoqërimit ishin, me sipërfaqe 4x4 m2 me hapësirë të mjaftueshme për qëndrimin e personave të shoqëruar. Dritaret e dhomave lejonin mundësi për realizimin e ajrimit e ndriçimit të plotë natyral. Dhomat ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjienike. Kapaciteti i ambientit të shoqërimit ishte për mbajtjen dhe qëndrimin maksimalisht të 12 personave, të ndara sipas dhomave.

Dhomat e shoqërimit kishin ndriçim nga rrjeti elektrik dhe ishin të pajisura secila me 4 karrige, tavolinë të fiksuar në dysheme për qëndrimin ulur të shoqëruarve. Në hyrje të korridorit ndodheshin dy tualete të ndara më vete për meshkuj dhe femra sipas standardeve të miratuara. Ato ishin të pastra dhe të pajisur me dushe, lavaman dhe ujë të rrjedhshëm 24 orë, korridori i këtij ambienti ishte i monitoruar me kamera. Në dhomat e shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar.

Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë komisarlat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Në Komisarlatin e Policisë Shkodër, gjatë periudhës 01.01.2020 deri më 22.12.2020 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **698** persona, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112/1 të ligjit për Policinë e Shtetit. Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë shtetas në dhomat e shoqërimit.

Nga inspektimi i ambienteve të shoqërimit gjendej një dhomë e veçantë për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar, e cila ishte e pajisur me tavolina, karrige dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, si dhe me orenditë e nevojshme si karrige dhe tavolina pune për specialistët e policisë¹ dhe ishin të instaluar kamerat e monitorimit.

¹¹¹ *Kreu VI, Pika 3/d procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.*

Gjithashtu, na informuan se personat e shoqëruar nga policia janë të informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore / procedurale që ata kanë. **Mekanizmi Kombëtar** sugjeron dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore që në momentin e hyrjes në Komisarariat.

Nga verifikimi i regjistrit të marrjes dhe dorëzimit të personit të shoqëruar dhe kopje të proceverbale të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin 2020 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

Grupi i inspektimit u informua nga drejtuesit e Komisarariatit, në lidhje me masat e marra me qëllim parandalimin e përhapjes së sëmundjes COVID-19. Në Drejtorinë Vendore kishte pasur raste të infektuar për të cilët ishte zbatuar protokollin e karantinës 14 ditore. Institucioni ishte dizinfektuar disa herë, shërbim i bërë nga Bashkia Shkodër. Gjithashtu, gjatë inspektimit u konstatua se gjithë punonjësit dhe drejtuesit e policisë ishin të pajisur me maska dhe kishte dezinfektues për tu mbrojtur nga përhapja e sëmundjes infektive COVID - 19.

Ambientet e sigurisë/kushtet e tyre dhe trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve

Dhomat e sigurisë në Komisarariat e Policisë Shkodër ishin në proces ndërtimi, sipas kërkesave të parashikuara në Procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Për ambientet e sigurisë ishin planifikuar gjithsej 14 dhoma sigurie me kapacitet 14 persona, të ndara dhoma për të rritur, dhoma për femra dhe dhoma për të mitur, sipas kërkesës së ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Aktit të procedurës standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me urdhrin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Nga verifikimet e bera në Drejtorinë/Komisariatit e Policisë Shkodër, rezulton se nuk janë kryer punimet brenda afateve ligjore të përcaktuar në kontratë për ndërtimin dhe rikonstruksionin e godinës së Drejtorisë/Komisariatit të policisë Shkodër, me sipërmarrës shoqëria “Junik” SHPK, me afat të përcaktuara 24 muaj nga data e fillimit me date 03.10.2018

Nga informacioni i dhënë nga Drejtuesit e Komisarariatit të Policisë Shkodër, deri në ndërtimin e dhomave të sigurisë, shtetasit e ndaluar apo të arrestuar në Komisarariatit Shkodër, transferohen në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë për verifikimet dhe procedurat e mëtejshme të tyre.

Bazuar në urdhrin nr. 1476/2 prot, datë 12.06.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e përkohshëm të të arrestuarve/ndaluarve të D.V.P. Shkodër, në ambientet e dhomave të sigurisë të

*Konisariatit të Policisë Lezhë në D.V.P. Lezhë*² parashikohet se çdo i ndaluar dhe i arrestuar nga D.V.P. Shkodër transferohet në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Lezhë, në DPV Lezhë, së bashku me dokumentacionin përkatës.

Nga data e nxjerrjes së urdhrin, gjatë kësaj periudhe janë ndaluar/arrestuar 217 shtetas, nga të cilët 6 femra dhe 3 të mitur, të transferuar në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në zbatim të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, procedurave standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, si dhe “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.938, dt. 24.07.2019, çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera edhe me regjistrat përkatës, për evidentimin e të dhënave të këtyre personave. Regjistrat në tërësinë e tyre ishin të mbajtur në rregull, të plotësuar sipas rubrikave dhe të sekretuar.

Gjatë inspeksionit u konstatua se në Komisarariatin e Policisë, Shkodër, regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar ishte i tipit “Model nr. 1”, konform me Procedurat Standarde.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” të ndryshuar regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrin ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë³.

Nga informacioni i marrë nga punonjësit e policisë si dhe nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave në konflikt me ligjin, sipas urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, transferohen në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë ku bëhet dhe procedura përkatëse e tyre, si ora e arrestimit/ndalimit në proces-verbalin e arrestimit apo ndalimit, përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për vitin 2020 nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.

² Urdhër nr. 1476/2 prot, datë 12.06.2020, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e përkohshëm të të arrestuarve/ndaluarve të D.V.P. Shkodër, në ambientet e dhomave të sigurisë të Komisarariatit të Policisë Lezhë në D.V.P. Lezhë”

³ Kreu VII, procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhërin Nr.938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Gjithashtu posterat e vendosur në institucion, pasqyronin edhe të drejtën e personave të ndaluar/arrestuar për të bërë ankesa apo kërkesa të natyrave të ndryshme.

Avokati i Popullit vë theksin se momenti i privimit nga liria është ora në të cilën nis llogaritja e afateve procedurale për efekt të llogaritjes së afatit maksimal prej 10 orë për personat e shoqëruar apo çdo afat tjetër për personat e ndaluar apo arrestuar.

Ambientet e intervistimit

Në Komisarlatin e Policisë Shkodër, ishin ndërtuar zyra apo ambiente të veçanta intervistimi për persona të shoqëruar në këto ambiente, të cilat ishin të monitoruara me kamera për kryerjen e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Nga monitorimi që iu bë zyrave të punonjësve të policisë në godinën aktuale të Komisarlatit të Policisë Shkodër, nuk u gjetën sende, prania e të cilave ekspozonte dhunë, tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Në këtë komisarlat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, e cila ka në varësi edhe Komisarlatin e Policisë ka në organikën e saj pozicionin e mjekut, nuk ka një person të emëruar që të ushtrojë këtë detyrë, por për çdo rast të caktuar vizitat përkatëse kryhen nga mjeku i Drejtorisë Vendore Lezhë.

Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës sugjeron zbatimin e rekomandimit të CPT, të drejtuar shtetit shqiptar për të cilin citohet se është e nevojshme për të siguruar zbatimin e dispozitave të përcaktuara në manualin / procedurën për trajtimin dhe sigurimin dhe kryerjen rigorozë të ekzaminimit mjekësor fillestar të personave të privuar nga liria⁴.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridoret e godinës të këtij Komisarlati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe mund të jetë e aksesueshme nga të shoqëruarit në mjediset e policisë ose t’u jepet në hyrje fotokopje.

⁴ “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT) on its visit to Albania”, Konsultuar: <https://rm.coe.int/16809cb571>.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të menjëherëshme për të përfunduar sa më parë ndërtimin e godinës së re të Drejtorisë Vendore të Policisë dhe Komisarariatit të Policisë Shkodër (Kontratë e cila sipas afateve kohore duhet të kishte përfunduar punimet për një periudhë 24 mujore, konkretisht 03.10.2020), sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, aktit të procedurës standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në policisë”, miratuar me Urdhrin Nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr.925, datë 18.07.2019.
2. Marrjen e masave të menjëherëshme për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër.
3. Marrjen e masave për pajisjen me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin në Komisariatin e Policisë Shkodër.

KOMISIONER

ERMONELA XHAFA